



Dalës-Izleazna

Nr. 1-193  
Br.

Data  
Datum

17.12.2018

OBILIO-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e 14) me dt.26.12.2018 (e mërkurë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i punës së Kuvendit komunal për vitin 2018
4. Raporti i performancës Komunale për vitin 2017
5. Raporti vjetor i Zyres së Personelit për vitin 2017
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Dalës-Izlažna

Nr. -1-072

Date 27.11.2018  
Datum

OBUDH-OBUH

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.27.11.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm janë këta anëtarë:** Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Qëndresa Dubova, Florije Jashari, Shaip Paloja, Linda Sadiku, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Arbnore Nasufi, Lulzim Sadiku, Hysni Mjeku, Samire Berisha, Aziz Bici, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** Naim Miftari, drejtari i DSHPE-së, Arben Berisha, drejtari i DPUKP-së, Fatmir Bërbatovci, drejtari i DKRS-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Agim Spahiu, drejtari i DKA-së, Ibush Mjekiqi, drejtari i DSHMS-së, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, Bejtullah Mjekiqi, shef i sektorit për bujqësi, Valmir Sadiku, (IZHL), përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it  
Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive "Adem Jashari" në Obiliq
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

**1.Pika e parë e rendit të ditës –**

**Mungoi:** Agon Mjekiqi pa arsy e Xhezide Dragusha me arsy

**2.Pika e dytë e rendit të ditës –**

**Aziz Bici** - Vërejtja ime në procesverbal është vetëm të shkruhet emri im sepse vota ime ka qenë kundër emërimit të sheshit "Adem Preniqi".

**Burim Gërguri** – Atë ditë ka qenë forma e thjeshtë e votimit, ndërsa herave tjera do të ju pyes dhe vendosim përmes formës e votimit.

**Lulzim Sadiku** - Është hera e dytë ose e tretë që ne kërkojmë të jetë një procesverbal shumë i thukët meqë, ne votojmë në mënyrë të hapur dhe derisa votojmë në mënyrë të hapur duhet të dihet saktë dhe të ceket kush si voton. Ju, kryesues është hera e tretë që thoni se s'ka problem, e rregulloj këtë çështje, por delë e kundërtë e kësaj. Unë kërkoj nga të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal, që të votojnë kundër këtij procesverbali sepse ne duhet njëherë e përgjithmonë ti rregullojmë këto gjëra të vogla që kanë peshë të madhe.

**Burim Gërguri** – Procesverbali nuk ka vërejtje dhe s'ka arsy e të mos votohet. Nëse, doni ne mund të ju pajisim edhe me një CD, përmes shkak të transparencës, por forma e votimit vendoset para çdo votimi.

**Lulzim Sadiku** – Nuk është hera e parë që jam në Kuvend dhe e di që bëhet inçizimi, por procesverbali duhet të jetë i saktë, të dihet dhe derisa është procesi i hapur i votimit, është e drejtë të shkruhet emri dhe

mbiemri se si do të votohet. Kjo po na sjellë në lajthitje shumë herë edhe pse herën e fundit ke thënë se do ta rregullojmë këtë çështje. Unë prapë jam shumë i pakënaqur me këtë procesverbal dhe prapë ju them kolegëve, që mos ta votojnë.

**Armend Rushiti** – Edhe unë jam i mendimit që kjo çështje njëherë e përgjithmonë të rregullohet në mënyrë që të dihet saktësish se kush çka ka votue. Është mirë që procesverbal të jetë sa më i mirëfilltë sepse kjo sqaron saktësish se kush çka voton në Kuvend.

**Burim Gërguri** – Lexon nenin 48 të Rregullores së punës së Kuvendit për çështjen e procesverbalit. Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal, me 17 vota “Për” 1 votë “Kundër” dhe 1 votë “Abstenim” e miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

### 3. Pika e tretë e rendit të ditës -

**Burim Gërguri** – Ju informoj se në mbledhjen e KPF-së, është diskutue kjo Draft Rregullore dhe kjo Rregullore i ka kalue të gjitha procedurat administrative, për me ardhë në aprovim në Kuvendin komunal.

**Fatmir Bërbatovci** – Ju njoftoj se kjo Rregullore ka pësue vetëm një plotësim ndryshim te neni 6.3, ku ju mundësohet klubeve të licencuara nga Ministria e kulturës dhe Drejtoria e kulturës, që ta shfrytëzojnë pa pagesë Palestrën sportive. Pra, bëhet fjalë vetëm për klubet komunale të cilat janë të licencuara.

**Shaip Paloja** – Mendoj se kjo është një Rregullore e mirë, por duhet të shtohen edhe disa gjëra. Psh thuhet se ekipet që janë jashtë Komunës tonë, do të bëjnë pagesa të caktuara dhe mua, më intereson se pagesa a do të bëhet në kesh në Drejtoren e kulturës, apo është një xhirolllogari ku do të derdhen ato mjete sepse këtu nuk është e përcaktuar. Unë them se duhet përshëndetur fillimi i gjitha ekipet e licencuara të Komunës, që kanë të drejtë të zhvillojnë aktivitetin e tyre pa pagesë dhe mendoj se kjo është një punë shumë e mirë. Te ekipet që zhvillojnë aktivitetin jashtë Komunës tonë, thuhet se 1 orë do të kushtoj 100 €, që mendoj se duhet të ceket se një lojë qoftë basketboll, apo hendboll nuk zgjatë vetëm 1 orë, por zgjatë 1 orë e gjysmë, 2 orë patjetër. Poashtu, duhet të përcaktohet saktë nëse zgjatë më shumë se 1 orë, a do të paguaj më tepër apo mjaftojnë 100 €. Te siguria në Palestër, të gjitha federatat e kanë të rregulluar që ekipi i cili bën gara është e licencuar në federatën e futbollit që gjatë zhvillimit të lojës kanë obligim ta ftojnë sigurimin ose Policinë e Kosovës, ose sigurimin privat. Kjo nuk është e përcaktuar në Rregullore, që mendoj se patjetër duhet të përcaktohet. Këtu fjalë është për lojë kryesisht liga e parë dhe super liga, fjalën e kam për sigurimin fizik të objektit që patjetër mos të zhvillohet lojë pa prezencën e sigurisë.

**Armend Rushiti** – E pyes drejtorin pse nuk është përfshi fusha artificiale në Plemetin, në këtë Rregullore dhe kush e shfrytëzon këtë fushë duke pasë parasysh se ka pasë vërejtje edhe nga auditori i jashtëm për mosinkasim të mjeteve.

**Fatmir Bërbatovci** – I përgjegjëm z. Armend, se kjo nuk është pjesë e kësaj Rregullore, shfrytëzimi i fushës sportive në Plemetin, që sigurisht në ndonjëren nga mbledhjet e ardhshme ka me u trajtue si temë. Ndërsa, sa i përket vërejtjeve të z. Shaip, nëse bën me ia kalue fjalën ish drejtoreshës së DKRS-së, e cila i ka informacionet më të sakta se unë.

**Fitore Hashani** – Ju e dini të gjithë se Komuna posidon një xhirollogari dhe të gjitha pagesat që bëhen në të gjitha institucionet, degë të Komunës bëhen përmes xhirollgarisë së Komunës. Asnjëherë DKRS-ja, nuk ka pranue të bëjë pagesa të drejtëpërdrejta, kështu që palët që e shfrytëzojnë Palestrën sportive bazuar në Rregulloren në fjalë, pagesat i bëjnë në xhirollarinë e Komunës. Pyetja tjetër ishte lidhur me sigurimin dhe policinë që duhet të jetë në ndeshje, këto janë të rregulluara edhe me federatat dhe me të gjithë akterët që e zhvillojnë ndeshjen. Kjo nuk është e paraparë në Rregullore sepse është një prej kushteve të secilës ekipë që zhvillon ndeshje sportive. Pyetja tjetër ishte rreth 1 orë për pa pagesë dhe këtë nuk e kemi përfshi aty sepse auditorët dhe gjithkush tjetër që i monitoron institucionet qeveritare kërkijnë arsyeshmëri për këto orë, nuk lejohet. Ne për këtë arsyen edhe pse e kemi dhënë në shfrytëzim Palestrën sportive, gjithëherë e kemi bërë llogarinë dhe e kemi kthyer në subvencion shfrytëzimin e saj, përvëç policisë, shoqatave të dalura nga lufta dhe FSK-së, që ju lejohet ti kenë 2 orë në muaj kur i kanë datat e aktiviteteve të tyre.

**Nazmi Gashi** – Ne jemi duke biseduar për aprovimin e një Rregulloreje, për një objekt për të cilin asnë anëtarë i Kuvendit komunal, nuk e din se në çfarë gjendje është. Ne po e aprovojmë një Rregullore dhe me i dërgue fëmijët aty për t'u mërdhirë, me marrë ftohje, me shkue e me marrë injeksione, nuk besoj se është e drejtë prej neve. Mendoj se drejtori duhet të na japë një sqarim se a është objekti në gjendje të përdorshme, a ka mungesa, a ka problem, çka duhet aty me ndërhye për me ndihmues. Unë kisha dashur të dijë një historik momental të objektit, një sqarim për gjendjen e tanishme të objektit.

**Lulzim Sadiku** – Unë e kam lexuar këtë Rregullore dhe më ka pëlqye si Rregullore, por kam parë se është çmim i lartë për klubet e jashtme. Ju e dini se në Kosovë, në Komunën tonë dhe në të gjitha Komunat klubet kanë problem me financa dhe çmimi prej 100 €, kërkoi të kthehet në 50 €. Mendoj se është në interes shumë më të madh nëse çmimi është më i lirë sepse shumë klube mund të vijnë, ti kemi psh 50 lojë gjatë 1 muaji se sa ti kemi 10 lojë nga 100 €.

**Fitore Hashani** – Përgjegjet se kushtet e Palestrës janë të mira dhe i plotësojnë kriteret e të gjitha ndeshjeve, përndryshe ne nuk kishim pasë të drejtë si Drejtori me zhvillue ndeshje. Sa i përket të ftohit aty, ne e dijmë se ajri i ftohtë është edhe i shëndetshëm dhe në momentin që nuk është e përballueshme për fëmiun, apo të rriturin ne nuk kemi të drejtë as me i realizue ndeshjet aty. Te çmimi është Rregullorja që është miratue më heret dhe ne mendojmë të inkasojmë të hyra prej klubeve gjigante psh që e kemi Prishtinën dhe Komunat përreth, e dijmë sa kanë buxhet dhe se si operojnë këto klube. Për këtë është një Rregullore, që edhe një çmim i përballueshëm të paktën deri më tanë s'kemi pasë vërejtje nga klubet tjera. Ne nuk e kemi Palestrën të specifikuar vetëm për klubet që janë në hapat e parë, apo që nuk janë të zhvillueshëm, por mendojmë ti kemi të gjitha klubet qysh i kemi pasë qoftë federatën e hendballit, të basketbollit apo ndërkombëtare. Ky është qëllimi i Komunës dhe DKRS-së, që të ketë sa më shumë të hyra dhe të mirëmbahet kjo Palestër gjigante.

**Shaip Paloja** – Unë nuk mora përgjegje në pyetjen që e parashtrova më heret. Aty përcaktohet për klubet jashtë Komunës tonë, 100 €, kushton ora dhe çdo lojë në minimum zgjatë 2 orë, ndërsa ata e kanë obligim të vijnë para kohës 1 orë. Mendoj se duhet të përcaktohet ora shtesë a do të paguhet apo jo. Megjithëse, edhe propozimi i z.Lulzim, më pëlqeu dhe është një propozim i mirë.

**Hysni Mjeku** – Unë kam dhënë vërejtje edhe më heret se me diskutimet dhe rekomandimet e KPF-së, është mirë të njoftohen anëtarët e Kuvendit komunal, përndryshe na detyroni neve si anëtarë të KPF-së prapë të diskutojmë për këtë materie. Unë besoj se Rregulloret janë në nivelin e duhur në aspektin profesional dhe në aspektin teknik. Sa i përket çështjes së pagesës për klubet jashtë territorit të Komunës tonë, mendoj se derisa kërkojmë të mirëmbahet ajo sallë, derisa kërkojmë kushte enkas, atëherë edhe për këto kushte duhen mjete materiale. Prandaj shuma prej 100 €, nuk është shumë e madhe sepse u tha nga parafolësi se aty duhet të vijnë 1 orë më heret, pastaj vazhdon loja që edhe kjo ka një kosto. Ne edhe po kërkojmë me mirëmbajtë mirë edhe po kërkojmë me zbritë çmimin, kështu që ose duhet me pasë mjete për me mirëmbajtë atë sallë, ose duhet të ngritet çmimi i ndeshjeve. Mendoj se 100 €, nuk është vlerë e madhe për 2, ose 3 orë dhe konsideroj se kjo sallë në të ardhmen duhet të menaxhohet më mirë për të pasë suksese në të gjitha sportet.

**Lulzim Sadiku** – Unë jam i profilit sportiv dhe në Rregullore nuk është cekë se a është një lojë 100 €, dhe a është 1 orë 100 €, por ju them se në shumë Komuna përreth neve 1 orë, ose një lojë paguhet prej 40–50 €. Ju merrne vetëm si mostër sepse nëse loja zgjatë 3 orë, do të thotë 300 €, me i pague një ekipë dhe ju e dini se nuk ka mundësi. Unë jam pro Rregullores, por besoni se çmimi real është çmim që i tejkalon masat që janë në regjionin tonë.

**Ibush Mjekiqi** – Meqenëse, një kohë të gjatë kam qenë në aktivitete sportive dhe prapë jam, mund t'ju them se çmimi prej 100 €, nuk është e rregulluar vetëm me këtë Rregullore, por edhe me Rregulloren për tarifa dhe ngarkesa komunale. Çmimi prej 100 €, për 1 orë paguhet për klube që vijnë nga qytete të ndryshme dhe ne kemi pasë rastin Trepça, të zhvillon lojë e cila për 2 orë ka paguar 200 €. Pra, paguhet për orë dhe sa zgjatë loja, aq paguhet, që nuk është çmim i lartë.

**Burim Gërguri** – E përgëzoj DKRS-në, për këtë Rregullore sepse të rinjët tonë tashmë, janë në një Palestër moderne, e kanë një aktivitet dhe atyre ju ofrohen shërbime. Për mua, është e rëndësishme që klubet e qytetit janë pa pagesë, ndërsa për klubet jashtë qytetit e aplikojmë modelin e qyteteve përreth. Tani, do të votojmë dhe ju pyes të vendosim se a do të jetë votë e hapur apo e numruar.

**Lulzim Sadiku** – Të votojmë me votë të hapur.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota “Për” dhe 4 vota “Abstenim” morën këtë:

#### V E N D I M

**Aprovohet Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Adem Jashari” në Obiliq.**

**4.Pika e katërt e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Ju njoftoj se debati publik për Rregulloren, është mbajtë me dt.19.11.2018, por fatkeqësiht kanë qenë vetëm 2 pjesëmarrës. Në mbledhjen e KPF-së, z.Hysni Mjeku ka propozuar që të rritet numri i Këshillave të fshatrave dhe të caktohet 1 kordinator i Këshillave të fshatrave. Mirëpo, në bashkëbisedim me kolegë që kemi pasë, është e pamundur të caktohet 1 kordinator sepse kordinator do të jetë Kuvendi, i cili do të monitoroj punën e vet dhe punën e Këshillave të fshatrave.

Kryesuesi lexon Këshillat e fshatrave ekzistues dhe propozimet e reja që kanë ardhë.

**Lulzim Sadiku** – Vërtetë, kam marrë pjesë nëpër këto Këshilla të fshatrave, kur janë formue kam qenë në një Komision të përbashkët me një grup prej Kuvendit. Mirëpo, kur kemi dalë në terren kemi hasë në problem, konkretisht ka qenë Hadja, që ju ka bërë zgjedhja e mirë për shkak se ata është dashur me iu drejtue Lajthishtës dhe fshatit Palaj, njëkohësisht Lajthishtës. Propozoj që edhe fshati Shipitullë me pasë Këshillin e fshatit, për shkak të largimit të problemeve që i ka, e poashtu, edhe Grabofci ta ketë Këshillin e fshatit sepse e dijmë se është pjesë shumë e përafërt. Mirëpo, për arsyet e problemeve që i kanë me shpërngulje nga fshati, kërkoj që edhe fshati Shipitullë të ketë Këshill të fshatit.

**Armend Rushiti** – Edhe unë jam i pajtimit që secili fshat në Komunën tonë ta ketë Këshillin e vet, në mënyrë që të jetë më funksional.

**Burim Gërguri** – Psh fshati Hamidi, ka numër të vogël të banorëve, duhet me pasë parasysh fshatin Bakshi e Raskovë, a mud të shkojmë me 1 Këshill, apo 2.

**Armend Rushiti** – Mendoj se duhet të ndahet, secili fshat me pasë Këshillin e vet.

**Aziz Bici** – Edhe unë jam për atë mundësish që secili fshat ta ketë Këshillin e vet dhe aty ku s’ka mundësi atëherë duhet të interesohemi se cili Këshill duhet të përkujdeset për atë fshat. Te neni 7, procesverbalini nga tubimi zgjedhor pika 1, është krejtë në rregullë vetëm se unë rekomandoj përveç numrit të qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim të shtohet edhe lista, ku në atë listë të evidentohet me emër e mbiemër, numrin e telefonit apo të emailit.

**Burim Gërguri** – Unë nuk e di se a ju ka ardhë realisht një raport sepse nga ish Komisioni unë e kam pranue një procesverbal me të dhënat nga gjithë anëtarët e Këshillave të fshatrave, Kryetarët e Këshillave të fshatrave dhe numrin pjesëmarrës. Ne duhet ti formojmë 2 Komisione, për organizimin dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, dhe ai Komision ka me sjellë për aprovim në Kuvend një raport gjithëpërfshirës me procesverbal.

**Enver Gashi** – Unë kam pasë fatin që kam qenë në Komision dhe e di çka domethënë Këshillat e fshatit, qysh zgjedhen dhe qysh bëhet një punë administrative edhe në terren. Ju njoftoj se krejtë dokumentacionin ne e kemi dorëzue të nënshkruar prej pjesëmarrësve që kanë qenë aty, të Kryesisë dhe të Kryetarit të Këshillit. Mirëpo, kemi pasë problem sidomos te bashkimi i lokaliteteve, që ne në mbledhjen e kaluar u morëm vesh që ti ndajmë psh pse mos të jetë edhe fshati Kozaricë veç, pastaj fshati Bakshi dhe Raskovë patjetër me qenë të ndarë. Obiliqi, i ka pasë dhe besoj se prapë do të jetë me 2, në vend të Dobrosellës me bë Shkabaj sepse Dardhishta me Shkabaj edhe pse janë një zonë zgjedhore, janë pak të ndarë dhe më afër me qenë përfaqësuesit e fshatit Shkabaj. Poashtu, Grabofci me Shipitullë me qenë të ndarë, ndërsa Hamidia ka pak banorë afër 10 shtëpi dhe nuk e shohë të arsyeshme me pasë Këshill të fshatit.

**Hysni Mjeku** – Në mbledhjen e KPF-së, kemi kërkuar që çdo lokalitet ta ketë Këshillin e vet dhe kam kërkuar në pasuesin e nenit në fund atje, të hiqen vendbanimet formale dhe joformale nga fjalori sepse aty ku s'ka banorë faktikisht nuk ka edhe Këshill të fshatit. Ne kemi propozue që çdo fshat ta ketë Këshillin e vet sepse kemi pasë probleme të fshatit Hade dhe kanë pasë të drejtë ata banorë që kanë protestue, kanë reague me kohë dhe për këtë ju kemi ikë ktyre problemeve. Ne nuk e kemi pasë kriter numrin e banorëve, nëse 2, apo 10 shtëpi janë banorë rezidentë në atë lokalitet, atëherë ai fshat duhet ta ketë Këshillin e vet. Edhe njëherë po e ceku se vendbanimet formale dhe joformale, ju lutemi teknikisht gjuhësish duhet të hiqen sepse nuk tingëllon mirë dhe është një Rregullore që duhet të plasohet në opinion, që nuk duhet ta ketë një përmbajtje të tillë. Unë kam kërkuar që të bëhet edhe pagesa sepse aty ku nuk bëhet pagesa nuk ka edhe sukses. Ne nuk duhet ti ikum Rregullores në fjalë sepse edhe ashtu ne jemi vonue te formimi i Këshillave nga se është dashur në muajin e 3, ose 4 të punimeve të Asamblesë me i zgjidhë këto probleme. Mirëpo, kurrë nuk është vonë, ne ju kemi hy procedurave dhe besoj se do ta përfundojmë me shumë sukses sepse me problemet e Këshillave ne si asambleistë e kemi obligim të debatojmë dhe të marrim vendime të rëndësishme.

**Shaip Paloja** – Mendoj se Këshillat e fshatrave nëse, funksionojnë ashtu si duhet, këto do të janë në funksion të mirë për të gjitha fshatrat ose vendbanimet. Gjithashtu, pajtohem me parafolësit e mi që çdo fshat të ketë Këshillin e vet, për arsyet e funksionimit se bazuar në përvojën e mëhershme nuk janë problemet e fshatrave të njëjtë në mbarë Komunën tonë. Psh problemet që i ka fshati Hade, nuk mund të krahasohen me problemet e x fshatit tjetër sepse janë probleme specifike dhe për këtë arsyet, ata patjetër duhet të kenë përfaqësuesin e vet. Gjithashtu, edhe të gjitha fshatrat duhet të kenë Këshillat e veta. Mendoj se nuk është i përcaktuar apo unë nuk e kam parë se kur zgjedhen Këshillat e fshatrave, sa është numri minimal i banorëve prezantë apo numri i banorëve nën të cilin nuk bën të formohet një Këshill. Propozoj që në Këshillat e fshatrave, mos të janë Kryetar të nëndegëve apo të pikave qysh janë të formuara subjektet politike. Eshtë mirë që Këshilli i fshatit të jetë i përbërë prej njerëzve që nuk janë as Kryetar të nëndegëve, apo aktive të pikave, dmth komplet Këshilli dhe Kryetari i Këshillit.

**Fatmir Bekteshi** – Atë që deshta me thënë unë e tha shefi i grupit parlamentar të Aleancës, dhe kur fshati Bakshi dhe Raskovë kërkojnë, atëherë edhe Kozarica duhet me pasë një përfaqësues të vetin.

**Nora Preniqi** – Dua të kyqem për Këshillin e fshatit Mazgit dhe Llazarevë, që u propozua të jetë i përbashkët. Unë propozoj të jetë i veçantë për shkak të problemeve sepse Mazgiti i përbën 2 Mazgite, dhe numri i banorëve është më i madh se ai i Llazarevës. Prandaj edhe dua që ai të jetë i veçantë, që secili fshat ta ketë përfaqësuesin e vet dhe që këta emrues të këtyre fshatrave mos të janë me ngjyrime politike.

**Hysni Mjeku** – Nuk ka fshat psh që nuk ka parti politike, së paku bile 5 dhe nëse, përashtohen të gjitha partitë politike, atëherë sinqerisht nuk di kend me zgjedhë aty.

**Shaip Paloja** - Unë thashë që në Këshillin e fshatrave që përbëhet prej 5-7 anëtarëve, mos të jetë Nënkyetari i nëndegës ose atij aktiv i sepse ne e dijmë se në secilin fshat jemi të përcaktuar për subjekte politike dhe aty s'ka dyshim.

**Enver Gashi** – Dua të bëjë një plotësim se nëse, në ndërkokë zgjedhet dikush prej Kryetarëve të Këshillave, Kryetarin e subjektit politik të atij lokaliteti, atëherë Komisioni i këtij Kuvendi duhet të marrë vendim dhe menjëherë atë ta shkarkoj dmth mos të jetë Kryetar i subjektit dhe Kryetar i Këshillit.

**Aziz Bizi** – Se kush do të zgjedhen, ne e dijmë se kemi anëtarë në secilin fshat. Unë kërkoj nga Komisioni që me përpikëri të zbaton Rregulloren e punës gjatë zgjedhjes së çdo Këshilli të fshatit.

**Naim Miftari** – E kam një vërejtje te neni 4, është formimi i Komisionit nga Kuvendi dhe është përbërja e tij nga 5 anëtarë, 2 anëtarë duhet të janë nga Kuvendi komunal, 1 anëtar nga Ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 nga përfaqësuesit e fshatit. Mendoj se Kuvendit i paraqet problem nxjerrja e vendimit përfaqësues të fshatit sepse në të kaluarën nuk ka qenë kështu, por ka qenë 2 anëtarë nga Kuvendi, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

**Burim Gërguri** - Në të kaluarën kanë qenë 2 Komisione sepse një Komisioni eshtë vështirë ti menaxhoj 20 vendbanime, lagje dhe fshatra, por edhe jemi dakordue që për punën e këtij Komisioni të bëhet edhe pagesa.

**Naim Miftari** – Propozoj konkretisht te nen 4, pika 1 e Rregullores, përbërja e Komisionit eshtë prej 5 anëtarëve, dhe kjo të mos ndryshon 2 anëtarë të jenë nga Kuvendi komunal, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

**Burim Gërguri** - Të gjitha vendbanimet që i njehë Statuti i Komunës, ne obligohemi me i votue, por ka vendbanime që nuk i njehë Statuti i Komunës si rastin Kozaricë, Shkabaj nuk e njehë dhe ne kur fillojmë me ndryshimin e Statutit të Komunës dhe njësive kadastrale, atëherë na plotësohet ajo mundësi. Ne për të gjitha vërejtjet dhe propozimet e dhëna, do ta bëjmë edhe një rishikim të Rregullores me zyren ligjore, në mënyrë që të jetë sa më e kompletuar. Propozoj që të votohet Rregullorja me kërkesën që të rritet numri i Këshillave të fshatrave, me 2 lagje urbane dhe 18 vendbanime.

**Enver Gashi** – Kryesues 2 Mazgitat, edhe ashtu kanë shumë banorë dhe gjeografia i ndanë. Ne po flasim për një Hamidi e për një Llazarevë, që eshtë sa një gjysmë Mazgiti i Ulët psh dhe mos të përfshihet Mazgiti i Ulët dhe Mazgiti i Epërm veçmas nuk ka kuptim.

**Burim Gërguri** – Propozimi final eshtë të kenë Këshill të veçantë Obiliqi i vjetër, Millosheva, Baimoci, Raskova, Bakshia, Breznica, Kozarica, Mazgiti i Epërm, Mazgiti i Ulët, Llazareva, Hadja, Palaj, Leshkoshiq, Sibofci, Hamidia, Plemetini, Grabofci, Shipitulla, Krushevi, pjesa Shkabaj-Obiliq me Haden e re dhe ndryshimet në nen 4, që i përmendi drejtori i administratës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimisht morën këtë:

#### V E N D I M

**Aprovohet Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Obiliqit.**

**Burim Gërguri** – Lexon 2 vendime të vitit 2015, për formimin e Komisionit për organizimin dhe përcjelljen e zgjedhjeve të Këshillave të fshatrave. Tash, e dua opinionin e juaj se a doni ti formojmë 2 Komisione, apo vetëm 1 Komision.

**Enver Gashi** – Propozoj që të jenë 2 Komisione, të ndahet terreni proporcionalisht dhe Komisionet ti kenë nga 7 anëtarë, 3 nga Kuvendi komunal, 3 nga Ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

**Lulzim Sadiku** – Propozoj që 7 anëtarë të Komisionit të jenë nga Kuvendi komunal, në mënyrë që të përfshihen të gjitha partitë politike.

**Burim Gërguri** – Sqaron se përbërja e Komisionit eshtë e caktuar me Rregullore.

**Shaip Paloja** – Rregullorja përcakton që 2 partitë shumicë në Kuvend, të caktojnë nga 1 anëtarë në Komision, por z. Enver Gashi, propozoi të jenë 3 anëtarë nga Kuvendi, që unë nuk e di se i treti nga cili subjekt vjen.

**Enver Gashi** – Sqaron se anëtarë i tretë vjen sipas radhës nga subjekti më i madh njëri në njërin Komision dhe tjetri sipas radhës në Komisionin tjetër, në mënyrë që të jemi gjithëpërfshire.

**Aziz Bici** – Unë kërkoj që strikt ti përbahemi Rregullores.

**Burim Gërguri** – Edhe unë jam për atë që ti formojmë 2 Komisione dhe të kemi një gjithëpërfshirje sa më të madhe të subjekteve politike.

**Aziz Bici** – Sot për sot nuk jam për me u thirrë apo interpretue Rregulloren sepse nuk e di, por derisa kemi fillue me i respektue Rregulloret ju e dini se kur i kemi formue Komitetet obligative në atë kohë, ne kemi mendue se eshtë dashur me qenë sa më gjithëpërfshire këto Komitete. Prandaj, prapë ju ftoj që gjithsesi kjo Rregullore të respektohet sot edhe nëse, ne nuk marrim pjesë në këtë Komision.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimisht morën këtë:

#### V E N D I M

**Që të formohen dy (2) Komisione për organizimin dhe përcjelljen e zgjedhjeve të Këshillave të fshatrave.**

Pas propozimeve të dhëna, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

## V E N D I M

**Formohet Komisioni për organizimin dhe përcjelljen e zgjedhjeve të Këshillave të fshatrave me këtë përbërje:**

- |                    |                          |
|--------------------|--------------------------|
| 1. Labinot Mirena  | (AAK)                    |
| 2. Fatmir Bekteshi | (LDK)                    |
| 3. Hysni Mjeku     | (PDK)                    |
| 4. Aziz Bici       | (LVV)                    |
| 5. Naim Miftari    | anëtar                   |
| 6. Fitore Hashani  | anëtar                   |
| 7. Valmir Sadiku   | anëtar (shoqëria civile) |

Dhe

Pas propozimeve të dhëna, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

## V E N D I M

**Formohet Komisioni për organizimin dhe përcjelljen e zgjedhjeve të Këshillave të fshatrave me këtë përbërje:**

- |                     |                           |
|---------------------|---------------------------|
| 1. Enver Gashi      | (AAK)                     |
| 2. Arbnore Nasufi   | (LDK)                     |
| 3. Lulzim Sadiku    | (PDK)                     |
| 4. Armend Rushiti   | (LB)                      |
| 5. Slavisa Spasic   | (SLS)                     |
| 6. Ibush Mjekiqi    | anëtar                    |
| 7. Zelushe Kelmendi | anëtare (shoqëria civile) |

### **5. Pika e pestë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën nga Bastri Statovci dhe për sqarim detal fjalën ia kalon drejtorit të DPUKP-së.

**Arben Berisha** – Ju informoj se kjo kërkesë nuk është e Drejtorisë, por e vet palës drejtuar Drejtorisë dhe Kuvendit komunal. Njëri prej anëtarëve të Kuvendit më tha se a don me të ndihmues, por nuk është punë për me më ndihmues sepse unë e kam dhënë sqarimin lidhur me kërkesën e palës dhe besoj se të gjithë e keni në material. Pala është në procedurë qe 8 vite, objekti ka përfundue dhe neve si Drejtori tash na ka ardhë me pajisë me leje ndërtimore. Ai ka hy vetëm në kushte ndërtimore, por leje nuk ka marrë sepse pala vet e specifikon se ka pasë probleme financiare. Nëse, ju merrni rekomandim ne i vazhdojmë procedurat për dhënjen e lejes, përndryshe pala mbetet deri në legalizim.

**Nazmi Gashi** – Anëtari i Kuvendit, që i ka thënë drejtorit se a don me të ndihmues jam unë dhe pse drejtori nuk ma përmendi emrin, për arsyet e respektit e pranoj se kam qenë unë. Unë kam arsyet e plota kur i thashë se a don me të ndihmues sepse në bazë të shkresës që e kemi marrë dhe sqarimit të materialit të kërkuar nga Kuvendi komunal, shihet se janë bërë shkelje të rënda dhe shkelje administrative ligjore. Kjo do të thotë se krejtë çka ta lejon ligji dhe ke pasë të drejtë me shfrytëzue, po kalon në një sferë politike. Ne jemi strukturë politike, nuk jemi Ekzekutiv dhe përgjegjësinë e dikujt që ka gabue nuk ka nevojë me na ngarkue neve. Thuhet se leja urbanistike është lëshue me propozimin e Bordit të drejtorëve, cili ligj dhe cila Rregullore e ka paraparë në atë kohë që Bordi i drejtorëve, ka të drejtë të merrë vendim. Shkelja edhe më e rëndë është se thuhet në sqarimin e lejes urbanistike, pala në bazë të dokumentacionit i ka plotësue të gjitha kriteret për pajisje me leje ndërtimore. Atëherë, pse pala nuk është pajisë me leje ndërtimore, por ju ka mundësue palës me i vazhdue punimet pa leje ndërtimore dhe thuhet mirë se edhe nëse, i plotëson kriteret urbanistike pala nuk guxon me i fillue ndërtimet pa u pajisë me leje ndërtimore. Propozimi im në bazë të përvojës është që Drejtoria ta formon një Komision i cili do ta bëjë verifikimin e gjendjes faktike, të shikohet se a është bërë shkelje ndaj lejes urbanistike, a janë plotësue kushtet urbanistike sepse edhe

legalizimi duhet të bëhet në këtë formë. Në fund në bazë të raportit që Komisioni e sjellë në Kuvendin komunal, Kuvendi mund ta aprovoj.

**Shaip Paloja** – Mendoj se kjo lëndë absolutisht nuk i përket Kuvendit komunal dhe ne nuk kemi të drejtë të marrim vendim për leje ndërtimore. Paraprakisht kishte me qenë mirë që zyra ligjore me na svarue se a është shkelje ligjore, apo nuk është. Këtu, fitohet përshtypja se kur Kuvendi nxjerrë vendim janë vendime kolektive, me votë të anëtarëve të Kuvendit dhe nëse shkelet ligji nuk ka përgjegjësi individuale, por ka përgjegjësi kolektive. Prandaj, nuk është mirë me na sjellë neve në këtë pozicion pavarësisht se ai ka ndërtue dhe ndoshta duhet ti lëshohet një leje, por ti lëshohet leja prej atyre që e kanë obligim me lëshue leje. Më heret i paska lëshue Bordi i drejtorëve dhe tash kush i lëshon unë nuk di, por është mirë të marrim një svarim prej zyres ligjore. Mendoj se ky objekt duhet të shkoj në legalizim dhe ne të mos merremi më me këtë çështje sepse nuk është çështje e Kuvendit komunal.

**Armend Rushiti** – Edhe unë pajtohem se dhënja e lejes së ndërtimit nuk është punë e Kuvendit komunal dhe dëshmia që e ka sjellë Drejtoria përkatëse, në faqen e parë, paragrafi 3, ku thotë se pala ka bërë pagesë prej 10,000 €, me dt.4 dhjetor 2010, nga pagesa e përgjithshme për pagesë 19,890 €. Pastaj, pala nuk ka vazhdue me procedura të mëtutjeshme për tu pajisur me leje ndërtimore ashtu si parashihet me Rregullore. Mirëpo, thuhet se pala ka vazhdue ndërtimin dhe në anën tjetër kërkohet që ne të ndërmarrim procedurat me ia mundësue atij që me vazhdue. Këtu, është një kundërthënje se ai ka pasë mjete me ndërtue, por nuk ka pasë mjete me rregullue lejen e ndërtimit. Mendoj se është dashur me na dëshmues se çfarë probleme financiare ka pasë ai që nuk e ka marrë lejen, ndërsa në anën tjetër ndërtimin e ka vazhdue. Kjo është shumë kundërthënëse dhe ne si Kuvend komunal, nuk mund ti bëjmë zgjidhje këtij problemi, por Drejtoria përkatëse duhet të merret me këtë problem.

**Aziz Bici** – Ashtu, qysh u deklarue drejtori na ka pajisë me informacion, por mendoj se ky njoftim nuk është i mjaftueshëm me na bind që ne me marrë vendim. Këtu, thuhet se Bordi i drejtorëve, ka qenë kompetentë për lëshimin e lejeve për ndërtim, ndërsa tash rekomandimi vjen vetëm prej drejtorit të Drejtorisë përkatëse. Mendoj se sikur të kishte ardhë rekomandimi prapë prej Bordit të drejtorëve, atëherë kishte me dalë se ose nuk jemi ne kompetentë me nxjerrë këtë vendim ose kishte me u ditë saktë se ku është problemi. Prandaj, mendoj se ne nuk jemi ata që duhet me nxjerrë këtë vendim.

**Lulzim Sadiku** – Edhe unë pajtohem me parafolësit se vërtetë nuk jemi të bindur me dokumentacionet e ofruara nga pala për të cilën po flasim. Nëse, vërtetë kjo çështje është prej vitit 2010, atëherë kërkoj që të prolongohet për një seancë tjetër dhe të kemi dokumentacion shtesë edhe nga përgjegjësi komunal njëkohësisht edhe nga pala. Pastaj të shohim se cilat janë detyrat përkatëse që na takojnë, përndryshe edhe ne jemi kundër që të aprovohet ky dokument.

**Hysni Mjeku** - Këtu, po thuhet se Kuvendi nuk ka të drejtë të merrë vendim, por unë ju them sinqerisht se ky Kuvend ka të drejtë të merrë vendim sepse për këtë jemi të thirrur, por mbi të gjitha është zvarritja e këtij problemi dhe që ne nuk po e dijmë se ku qëndron fakti. Propozoj që Kuvendi komunal, të nxjerrë një rekomandim dhe ti thuhet Drejtorisë përkatëse, që në afatin më të mundshëm të nxjerret një vendim ose ti ndalohet, ose ti jepet leja e ndërtimit. Përndryshe pse po na mundoni neve këtu, dhe mos të ndodhë më psh që një problem 8 vjet me u zvarritë sepse këtu diçka është në pyetje. Mendoj se nuk janë në pyetje mjetet financiare sepse ai kur ka pasë mundësi 300.000 ose 400,000 €, me investue, ka pasë mundësi ti paguaj edhe ato 10,000 €, sa kanë qenë. Ne nuk jemi organ hetues, por jemi organ që marrim vendime, prandaj propozoj që kjo çështje ti rekamandohet Drejtorisë përkatëse dhe ta zgjidhë njëherë e përgjithmonë.

**Burim Gërguri** - Unë personalisht jam për atë që t'ju ndihmojmë bizneseve, por Kuvendi nuk lëshon leje të ndërtimit sepse këtë të drejtë e ka DPUKP sipas ligjit dhe Komisionit të formuar nga drejtori që i paraprijnë pëlqimet përkatëse nga Drejtoritë përgjegjëse.

**Enver Gashi** – Ne duhet ti rekamandojmë Drejtorinë përkatëse, dhe Drejtoria le ti kryen punët sipas ligjit, që ta zgjidhë këtë problem.

**Nazmi Gashi** - Unë prapë po them se DPUKP, le ta zgjidhë këtë rast përmes një Komisioni dhe në fund Komisioni neve, na e bën një raport për Kuvendin komunal, pasi që ky është i vetmi rast që po kalon

përmes Kuvendit. Në fund ai njeri mund të pajiset me leje sepse qe 20, ose 30 vjet jepë kontribut në Komunë. Ne nuk po i ikum përgjegjësisë, por po e japim kontributin tonë aq sa na lejohet dhe është mirë me i ndihmues atij, por në mënyrë të kapshme.

**Aziz Bici** – Mendimi im është se ne nuk kemi as nevojë me i rekomandue Drejtorisë sepse është detyrë dhe përgjegjësi e Drejtorisë dhe më duket se vetëm i komplikojmë gjërat edhe mëtutje.

**Burim Gërguri** – Fakti është se a dojmë ti kemi ato të hyra dhe me falenderue njeriun që e ka pague një pjesë ose me pritë ligjin e legalizimit. Ky njeri e ka një aktvendim, por ka mbetë që nga viti 2010 dhe nuk e di pse ka mbetë, por është mirë ti rekomandojmë Drejtorisë, ashtu qysh rekomandoi z.Nazmi Gashi, që me zgjidhë këtë problem.

**Arben Berisha** – Drejtoria dhe Ekzekutivi në këtë drejtim japid vetëm sqarim atëherë kur ju keni nevojë dhe kërkesa. Unë kërkesë nuk kam bërë, por pala ka bërë kërkesë dhe unë ju kam dhënë sqarim me rekomandim në fund. Mendoj se nuk është mirë ne të merremi me çështjen pse është lejue me u ndërtue, por ne duhet të merremi me çështjen konkrete. Në bazë të dokumentacionit që neve na ka ardhë për legalizim, unë nuk e di se qysh ky ka me hy në legalizim kur është veç në procedurë, që e ka pague një pjesë të mjeteve dhe ka me pague edhe pjesën tjetër. Nëse, i ndihmoni biznesit, ndihmoni dhe ne do të kemi edhe një të hyrë prej 10,000 €, si dhe ne mund të dalim nga kjo situatë.

**Aziz Bici** – Po dalim sikur nuk dojmë me i ndihmues, por ne secili jemi për me i ndihmues biznesit dhe këtu, është arsyaja që ne po kërkojmë rrugë ligjore. Ne e dijmë se profesionalisht përgjegjësi jepni ju drejtorët, e jo ne por sikur ta kishim një rekomandim të Bordit të drejtorëve aktual neve, na e kishit lehtësue marrjen e çfarëdo vendimi. Ndërsa, me një rekomandim të drejtorit mua më duket se ne nuk jemi mjaftueshëm të informuar.

**Arben Berisha** – Sqaroj se nuk është puna e Arben Berishës, por është puna e drejtorit. Unë nuk kam dashur me ju sjellë në lajthitje dhe shumë mirë e kam shkruar rekomandimi i DPUKP, Kuvendi të nxjerrë vendim që DPUKP, të vazhdoj me procedura për dhënjen e lejes ndërtimore sipas ligjit.

**Burim Gërguri** – Ne i kemi 2 propozime për këtë çështje, që ti rekomandohet Drejtorisë për vazhdim të procedurave dhe propozimi tjetër të prolongohet. Tash, propozimin e parë që ti rekomandohet Drejtorisë për vazhdim të procedurave, e hudhi në votim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 9 vota “Për” dhe 8 vota “Kundër” morën këtë:

#### R E K O M A N D I M

**I rekomandohet DPUKP-së, që të vazhdon me procedura sipas ligjit për dhënjen e lejes ndërtimore për palën Bastri Statovci.**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën nga DEFZH mbi tatimin për pronën e paluajtshme dhe për sqarim më detal fjalën ia jepë drejtoreshës së DEFZH-së.

**Zarife Behluli** – Ju njoftoj se Ligji nr.06/L-005, për tatimin në pronë e ka shfuqizu ligjin nr.03/L-204, për tokën e paluajtshme dhe asnjë ndryshim nuk është nga Rregullorja e kaluar, por i vetmi ndryshim është te tatimi në toka. Norma tatimore është 0.15 %, duke u bazuar me zonat kadastrale dhe secila zonë tatimohet me 0.15 % tatimi në toka dhe ky është i vetmi ndryshim. Rregulloren e re e ka miratuar Qeveria e Kosovës dhe ne jemi të obliguar të marrim vendim për normat tatimore, tatimi në tokë.

**Burim Gërguri** – E kemi sqarue edhe në mbledhjen e KPF-së, dhe uroj të zgjidhet problemi lidhur me pronat. E lus drejtorin e DPUKP-së, një projekt ka qenë me AER-in, para 2 viteve që është zgjidhë çështja e pronave për 5 fshatra dhe mundësishët nëse, vazhdoni me atë projekt edhe për fshatra tjerë, do të bëhet një zgjidhje e jashtëzakonshme për pjesën e mbetur.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 3 vota “Kundër” dhe 2 votë “Abstenim” morën këtë:

#### V E N D I M

**Mbi Tatimin e Pronës së Paluajtshme për vitin 2019.**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën nga kompania CNC, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, pronar Selman Kadriu.

**Lulzim Sadiku** – Unë vërtetë këtë kërkesë e kam analizue mirë dhe ju e dini se kur janë çeshtjet pronësore unë gjithmonë jam i thukët, mundohem ta japë mendimin e duhur në kohën e duhur. Unë do ti them po shëndrrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore sepse firma që kërkon me bë këtë ndryshim ka një sistem të makinerisë, një makinë që quhet CNC. Unë do të kërkoj prej Kryetarit, drejtorit të Arsimit, që këtij biznismeni ti jepet ky shëndrrim me një kusht që fëmijët e shkollës teknike ta bëjnë pjesën praktike sepse kjo është një firmë e njohur dhe konkretisht pjesa e makinerisë të shkollës së mesme ka të bëjë me këto makina të cilat priten të vijnë në atë vend për të cilin po flasim. Unë jam pro kësaj kërkesë që të bëhet shëndrrimi i tokës bujqësore në atë ndërtimore.

**Armend Rushiti** – Unë kam një pyetje për Drejtorinë përkatëse, se a është me plan zhvillimor e planifikuar për ndërtim kjo pjesë ku kërkohet të bëhet shëndrrimi i tokës bujqësore në atë ndërtimore. Nëse, është për ndërtim kërkoj sqarim shtesë nga Drejtoria përkatëse.

**Nazmi Gashi** – Veç a po ndërtohet diçka se ne po e votojmë, që edhe ne me ia pa hajrin diçka.

**Hysni Mjeku** – Drejtoria përkatëse, nuk e di a po na njofton pak sepse duhet kogja njëfarë procedure për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore sepse aty po i humbim 3 ha tokë, që nuk është pak. Meqenëse, jemi deklarue për hapjen e bizneseve sepse në Komunën tonë kemi pak biznese edhe unë jam pro kësaj kërkesë dhe jam për me marrë vendim që ky kandidat ta zhvilloj procesin normal, do të thotë në aspektin teknik profesional të mos zvarriten procedurat.

**Shaip Paloja** – Ne e kemi marrë një material dhe aty thuhet se kjo kompani ka një biznes dhe do të prodhoj kryesisht mjete për automobila të firmave gjermane, por për çudi nuk thuhet se ku punon dhe deri ku ka punue deri më tani. Unë jam kundër asaj që me shëndrrue tokën bujqësore në industri sepse industri Komuna jonë ka mjaft. Tani, a i plotëson kriteret për ndotje të ambientit, a do të ketë punësim sikur shumë e shumë tjerëve, që ju kemi dhënë leje dhe Komuna jonë nuk ka punësim dhe shumë kritere tjera, mendoj se ky Kuvend nuk duhet ta miratoj kërkesën e kësaj kompanie. Mirëpo, paraprakisht ndoshta është mirë të formohet një Komision nga Kuvendi dhe të shkoj ti vizitoj ato punime ku ai i bën, me çka punohet sepse përmendet edhe plastika që mund të ketë psh një ndotje të madhe. Poashtu, është edhe një sipërfaqe e madhe e tokës, që ne po ia lejojmë nëse ia lejojmë, kështu që i rekomandoj Kuvendit që të kërkoj material të mëtejmë ose të vizitoj një punishte ku ai punon nëse, punon.

**Labinot Mirena** – Pajtohem me Shaipin që të formohet një Komision, me dalë me vizitue atë dhe me pa se ku është toka, a ia vlen me i dhënë në shfrytëzim 3 ha tokë, apo jo sepse 3 ha tokë janë shumë.

**Lulzim Sadiku** – Unë në fillim ju thashë se e kam bërë një analizë të thukët, flitet për 30 ari, pronë private e cila kërkohet të shëndrohet nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Firma për të cilën po flasim unë e njohë dhe e njohin një numër i madh i njerëzve në hyrje të Prishtinës, ka një numër shumë të madh të punëtorëve dhe shumë shkolla të Prishtinës, kryejnë pjesën praktike. Unë kam qenë pjesë e procesit mësimor një kohë të gjatë dhe atë e njohë si një firmë shumë serioze, prandaj jam pro kësaj kërkesë.

**Bejtullah Mjekiqi** – Unë e kam sugjerue edhe kryesuesin se kompania ose parashtuesi i kërkesës është dashur të ndjekë rrugën zyrtare sipas ligjit. Kërkesa është dashur të vjen në Drejtorinë e bujqësisë dhe Drejtoria e bujqësisë e përcjellë në Ministrinë e bujqësisë, ata jadin pëlqim ose refuzim dhe ai pëlqim ose refuzim vjen në Kuvendin komunal.

**Arben Berisha** – Në seancën e ardhshme të Kuvendit, do t'ju informoj saktë lidhur me planin zhvillimor, ku ndodhet parcela sepse nuk kam ide se ku është dhe rreth Komisionit, që ju po pretendoni me formue.

**Enver Gashi** – Unë jam për atë që të ndjeket procedura ligjore siç e tha shefi i Drejtorisë së bujqësisë.

**Shaip Paloja** – Sugjeroj që gjithsesi të ndjeken procedurat ligjore, por edhe nëse ndjeken procedurat ligjore mendoj se ky Kuvend duhet të shkoj të bëjë një vizitë aty, se çka do të ndërtohet dhe si do të funksionon ajo kompani.

**Lulzim Sadiku** – Unë në fakt u mundova me dhënë më shumë kontribut, isha për atë që të votohet, të fillojnë procedurat dhe ti ndihmohet një operatori ekonomik aq serioz sa që një Komunë, mund ti dërgoj fëmijët që të kryejnë pjesën praktike. Unë jam për atë që ti jepet mundësia ti ndjekë procedurat, por

Kuvendi komunal mos ta vonon këtë procedurë sepse ne shumë herë po i votojmë gjërat, që nuk janë në interes të Kuvendit komunal. Ajo është pronë private e individëve të caktuar dhe ka kërkuar të bëhet një ndryshim i tokës, ndërsa ne e prolongojmë për 6 muaj, ose 1 vit derisa ta kthen Ministria. Unë jam pro kësaj kërkese.

**Armend Rushiti** – Unë jam për atë që të ndjeken procedurat ligjore

**Aziz Bici** – Unë jam për me i ndjekë procedurat ligjore.

**Slavisa Spasic** – Unë jam për atë që të respektohen procedurat ligjore.

**Dragan Dancetovic** – Jam për atë që të respektohen procedurat ligjore.

Pas diskutimeve, mbetet që kjo kërkësë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal.

**Burim Gërguri** – Lexon kërkësën nga klubi i kalërimit “Mazgiti” për dhënjen në shfrytëzim të një parcele për ndërtimin e një shtalle dhe hanit të kalorësve për aktivitete sportive.

**Nazmi Gashi** – Këta, djem nuk kanë kërkuar me pre malin dhe nuk janë gjuetar që shkojnë dhe vrashin shtazë që nuk lejohen, por janë njerëz që merren me aktivitete sportive, janë njerëz që vetëm e rregullojnë terrenin dhe na bëjnë të mundur edhe ne ti vizitojmë nganjëherë. Përndryshe veç deri në Vlorë që kanë shkue me kalë duhet me ua bë një respekt dhe mos me i pengue.

**Lulzim Sadiku** – Edhe unë jam pro këtij sporti, vërtetë po ju flas si profesionist, është një sport që ndihmon fizikisht, psiqikisht, relakson, përtrin dhe formon njerëzit e përgjithshëm dhe të gjithëanshëm. Përndryshe, po më pëlqen edhe vendi i duhur në kohën e duhur dhe jam pro kësaj kërkese sepse nuk dëmon, as nuk lëndon askend brenda Komunës tonë.

**Shaip Paloja** – Të gjithë ne jemi për sport dhe s’ka dyshim aty, por çfarë sporti do të zhvillohet. Ne e kemi një memorandum në mes të disa Komunave, për atë pjesë dhe vet kërkesa është drejtuar pak në mënyrë të çuditshme, sepse kërkohet një pronë e Agjensionit të pyjeve

**Burim Gërguri** – Sqaron se nuk e kanë pasë të qartë dhe mua, ashtu si më vjen materiali ua dërgoj edhe juve.

**Hysni Mjeku** – Këtu, shumica e asambleistëve disa janë më të vjetër e disa më të rinjë, por ajo zonë është shpallë zonë me interes të veçantë në Komunën tonë, për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit. Unë paraprakisht jam pro kësaj kërkese dhe duhet t’ju ndihmohet edhe në aspektin financiar sepse është një sport i qëlluar në vendin e qëlluar siç tha edhe z.Lulzim Sadiku, sepse vërtetë unë këta djem i admiroj dhe ju uroj sa më shumë suksese. Unë jam pro kësaj kërkese.

**Aziz Bici** – Edhe ne do ta përkrahim gjithsesi.

**Enver Gashi** – Poashtu, edhe ne e përkrahim.

**Burim Gërguri** – Unë i përgëzoj për iniciativën që e kanë marrë dhe vullnetin meqenësse, është një sport i kushtueshëm për me vprue në forma të tilla. Besoj se në vitin e ardhshëm sipas Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe planit të punës të DKRS-së, do të kenë të drejtë me aplikue dhe mund të bëhet ndarja e subvencioneve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

## V E N D I M

**Aprovohet kërkesa e Klubit të kalërimit “Mazgiti” për dhënjen e parcelës në shfrytëzim, e cila është pronë e Agjensionit të pyjeve të Kosovës, me nr.00336-200336-1, në fshatin Grabofc i Epërm.**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkësën nga DSHPE-ja, lidhur me shfrytëzimin e lokaleve komunale në objektin “D dhe GJ”. Tani, propozoj të formohet një Komision nga Kuvendi komunal me trajtue këtë lëndë me të gjitha rekomandimet nga zyra kombëtare e auditorit dhe me na sjellë një raport se si duhet të zgjidhet problemi në fjalë.

**Naim Miftari** - Kërkesa ime është e bazuar në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit dhe çështja është shfrytëzimi i lokaleve komunale pa marrëveshje. Pajtohem me propozimin për formimin e Komisionit, që të shikohet mundësia e zgjidhjes së këtyre problemeve.

**Lulzim Sadiku** – Pasi që jemi në prag të festave, kërkoj që kjo pikë të shtyhet deri në seancën e ardhshme sepse po preket me shoqatat e dalura nga lufta dhe të mos bisedohet për formimin e Komisionit në këtë situatë në të cilën gjendemi tash.

**Shaip Paloja** – Mendoj se zyret ku janë subjektet politike dhe organizatat e dalura nga lufta ky Komision nuk duhet ti trajtoj fare. Nëse, zyret ju kanë dedikue subjekteve politike, por shfrytëzohen për bizneset tjera, atëherë kjo është diçka tjetër. Unë ju kisha lutë se zyret e subjekteve politike dhe të organizatave të dalura nga lufta nuk duhet të preken. Në material ne nuk i kemi të gjeturat e auditorit, çka ka gjetë psh për zyren e organizatave të dalura nga lufta, çfarë shkelje janë.

**Burim Gërguri** – Sqaron se nuk është puna te zyra e LDK-së, as e veteranëve. Në vitin 2010 është nxjerrë një vendim, por nuk është ekzekutue kurrë dhe afér LDK-së thuhet të jetë AAK-ja, afér AAK-së, të jetë PD-ja, etj. Askush nuk po e konteston vendimin për veteranët e luftës, invalidët apo LDK-në. Duhet të shfuqizohet vendimi i vittit 2010 dhe Komisioni të sjellë një raport në Kuvend me rekomandim si të zgjidhet kjo çështje.

**Shaip Paloja** – Vendimin e vittit 2010, e ka implementue LDK-ja dhe shoqatat e dalura nga lufta, por subjektet tjera pse nuk e kanë implementue, nuk e di. Komisioni duhet të merret me ato subjekte të cilat nuk e kanë implementue vendimin e vittit 2010, ndërsa subjektet që e kanë implementue nuk mendoj se duhet me u marrë me ato.

**Nazmi Gashi** – Unë e kam një mendim krejtë ndryshe, që këto objekte me i marrë në dispozicion Komuna, me i kontrollu dhe mos me ua dhënë partive të mëdha, të cilat edhe kanë buxhet, i kanë marrë kur kanë qenë në pushtet dhe po i mbajnë ende me fuqi politike. Mendoj se për me zhvillue sistemin demokratik politik në Komunën tonë, duhet me ju ndihmues atyre që janë të vegjël, që s'kanë e qëndrojnë nëpër trafika dhe fare nuk hyjmë në mëkat me këta të mëdhenjtë. Nëse, është mundësia që krejtë këto hapësira me ua dhënë bizneseve, me u gëzue dikush dhe me fitue dikush diçka.

**Labinot Mirena** – Propozoj që të formohet një Komision prej 3 ose 5 anëtarëve dhe të vazhdojmë sepse tash jemi në festat e nëntorit dhe kemi aktivitete familjare.

**Hysni Mjeku** – Unë jam për atë që kjo çështje të prolongohet për mbledhjen e ardhshme sepse edhe ashtu kemi pritë prej vittit 2010. Tani, dua ti kundërvihem pak z.Nazmi Gashi, në mënyrë shoqërore ai që e ka 1 mollë, le ti merrë 2 molla, ndërsa ai që nuk e ka asnje, asnje. Ti je parti shumë e vogël minore, boll e ke që je këtu në Kuvend dhe të përgëzoj që ne po të bëjmë shoqëri këtu e po të respektojmë, faleminderit shumë.

**Aziz Bici** – Lidhur me shfuqizimin e vendimeve të lokaleve në objektin “D dhe GJ” në rr.”Hasan Prishtina” të cilat i kanë në shfrytëzim organizatat e dalura nga lufta e UÇK-së dhe LDK-ja, ne do të votojmë kundër shfuqizimit të këtyre vendimeve. Ne konsiderojmë se pa u formue një Komision në të ardhmen që vepron dhe vlerëson në bazë të kritereve të caktuara sepse në çdo mënyrë tjetër të vlerësimit të bën të dyshosh për keqpërdorim dhe korruption sikurse herën e kaluar ku pronën publike e keni ndarë në baza partiake, militante dhe baza të përfitimeve personale. Shfrytëzoj rastin dhe ju bëjë thirrje punoni sipas kritereve pa anime partiake, përndryshe ju secilën herë po bëni të humbë besimi i qytetarëve në institucione duke i lënë ata pa shpresë, pa vullnet, pa mundësi zhvillimi e mirëqenie në vendin e tyre dhe duke ndikuar kështu në largimin e tyre jashtë vendit.

**Burim Gërguri** – Të gjitha partitë kanë vendim për ato zyre, por nuk i kanë shfrytëzue kurrë sepse kanë qenë të uzurpuara. Askush nuk po e konteston LDK-në, dhe PDK-në që janë aty, por partitë tjera që e kanë vendimin dhe nuk po e gëzojnë vendimin. Këtu, nuk po bëjmë politikë përkundrazi kategoritë e dalura nga lufta janë kategoritë shenjta, jemi në prag të festave dhe duhet ti respektojmë maksimalisht. Komisioni i cli do të formohet do ta bëjë një raport të gjendjes faktike se cilat vendime nuk janë zbatuar kurrë, kush i ka pasë dhe kush i ka, në mënyrë që rekomandimi i zyres kombëtare të auditorit të përbushet.

**Aziz Bici** – Unë nuk isha për atë se duhet me i mbajtë as organizatat e dalura nga lufta, as LDK-ja, dhe unë nuk e dhashë mendimin se ato duhet me mbajtë. Mirëpo, Komisioni i cili formohet dhe vendos se kush duhet ti shfrytëzoj ato lokale duhet të jetë i drejtë.

Pas diskutimeve, kërkesa e DSHPE-së, prolongohet për mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal.

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake dhe për një sqarim më detal fjalën ia jepë drjtoreshës së financave.

**Zarife Behluli** – Ju njoftoj se DEFZH ka realizuar të hyrat vetanake për vitin 2018 të planifikuara në vlerën prej 876,728 €. Në periudhën gjysma e tectorit dhe deri në një pjesë të nëntorit është bërë tejkalimi i të hyrave 34,330.50. Arsyja që nuk ju ka ardhë në KPF, është se unë kam dashur që të hyrat të janë sa më shumë të grumbulluara për me ua sjellë juve, në Kuvend dhe që është obligim ligjor Kuvendi të merrë vendim për rritjen e të hyrave vetanake. Këto të hyra vetanake, në konsultim me Kryetarin dhe Ekzekutivin i kemi ndarë në 2 kategori ekonomike, mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale në vlerën e caktuar që ua kam dorëzuar me raport.

**Lulzim Sadiku** – Kërkoi që kjo pikë të shtyhet dhe të vjen përmes KPF-së, në seancën tjetër sepse ka të bëjë direkt me financa, që ti bëhet një analizë më e thukët, pastaj të vazhdojmë në Kuvend.

**Enver Gashi** – Unë nuk e di arsyen pse me u shtye kur janë shifrat e caktuara, mjetet e caktuara, e ke vijën e caktuar dhe ky nuk është problem që është jashtë Komunës, por brenda Komunës. Atëherë, pse të mos shpenzohen këto mjete, kur ka mundësi të shpenzohen dhe thjeshtë të kanalizohen në shpenzime komunale dhe në mallra e shërbime. Ne jemi për atë që të kaloj kjo çështje.

**Burim Gërguri** – Drejtoreshë, unë ju përgëzoj për tejkalim të buxhetit dhe për punën e madhe që e keni bërë, por ju pret punë edhe më e madhe në vitin 2019. Mendoj se shpenzimet komunale duhet të rriten nga se i di problemet që i ka DSHPE-ja, sepse po kërkojmë shërbime ndërsa mjete ka pak, por besoj se në vitin e ardhshëm ne e kemi ndarë buxhetin, që mos të kemi më probleme të tilla.

**Lulzim Sadiku** – Kërkoi që të gjendet forma dhe shpenzimet komunale të zvoglohen psh nëse, e marrim ambullantën në Baimoc, e dijmë se në çfarë gjendje është shërbimet komunale i heqim ne, por i kemi vetëm 2 punëtorë 1 mjek dhe 1 teknik medicinal ndërsa, 19 janë që paguhen nga Serbia. Kërkoi që ajo ambullantë të mbyllët, të vijnë ata në Milloshevë, derisa të rregullohet, të zvoglohen shërbimet dhe të bëhet një menaxhim shumë më i mirë. Këtu, është një mundësi për shifrën që po flasim, vërtetë të bëhet më e vogël. Unë jam pro kërkesës që të kaloj përmes KPF-së, për arsyen se i takon financave.

**Burim Gërguri** – Ne jemi në shërbim për të gjitha komunititetet, ndërsa është çështje politike e nivelit nacional për me u zgjidhë ajo çështje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 9 vota “Për” 3 vota “Kundër” dhe 5 vota “Abstenim” morën këtë:

## V E N D I M

### Për tejkalinin e Të Hyrave Vetanake të planifikuara për vitin 2018.

#### 6.Pika e gjashtë e rendit të ditës –

**Lulzim Sadiku** – Ka qenë një kërkesë nga familja Shaljani dhe Shehu, që ju kanë drejtue Kuvendit komunal dhe Drejtorisë përkatëse, për një rrugë në Sibofc ku ata si familje nuk janë të përfshirë. Ju si Kuvend komunal, më keni thënë mua se duhet ti sjellë nënshkrimet, ata ti drejtohen Drejtorisë dhe Kuvendit dhe ajo ka ndodhë. Tani, është muaji i tretë, ndërsa në Kuvend nuk ka ardhë fare dhe ata dojnë përgjegje pse po ndodhë kjo. Nënshkrimet e këruara janë ardhë komplet të familjes, që ajo rrugë të mbanë emrin e një mësuesi të asaj familjeje, por nuk kanë marrë asnjë përgjegje. Kërkoi të gjitha kërkesat të vijnë në Kuvend sepse disa vijnë e disa jo, kështu që edhe ne si kuvendarë ndjehemi jo mirë.

**Burim Gërguri** – Unë e them me plot përgjegjësi se një kërkesë e tillë për Kuvend nuk më ka ardhë.

**Arben Berisha** – Sqaron se ne palës i kemi propozue se Drejtoria, e ka mandatin vetëm me emra rezervë që i kemi për rrugën në fjalë, ndërsa për emra të ri që propozohen nga pala duhet të bëhet kërkesë drejtëpërdrejtë në Kuvend, e jo në Drejtorinë tonë. Ne e kemi refuzuar kërkesën me arsyetimin që pala ta dorëzoj kërkesën në Kuvend.

**Lulzim Sadiku** – Kërkesa është dorëzuar me nënshkrime, me personin zyrtar nga Sibofci, ju ka drejtuar shumë qartë Drejtorisë përkatëse dhe Kuvendit komunal. Unë atë kërkesë e kam pasë vetë në dorë, por do ta tërheqi nga arkiva dhe në seancën e ardhshme do ta sjelli.

**Armend Rushiti** – Kuvendi komunal, në mars të vitit 2018, ka marrë një vendim për shpalljen e zonës me interes publik dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private, për interes të banorëve të fshatit Bakshi. Meqë, kanë kaluar 8 muaj dhe ende nuk kemi ndonjë përgjegje atëherë, kërkoj nga drejtori i Drejtorisë përkatëse, të na shpjegoj procedurat deri ku ka shkue kjo si lëndë.

**Burim Gërguri** – Ne e kemi bërë hapin fillestare që e kemi shpallë zonë për këmbim të pronës së paluajtshme, por Ministria e financave, Komisioni ndërministror ende nuk e ka bërë një vlerësim dhe pa një vlerësim të tillë, ne nuk ndërmarrim asnjë hap.

**Arben Berisha** – Në seancën e radhës do t’ju japë informata për këtë çështje.

**Fatmir Bekteshi** – Unë i kam disa kërkesa dhe i kam disa vërejtje. E kam një kërkesë për DSHMS-në, nga Musa Zeka, i cili është në trajtim nga sëmundja e kancerit. Meqë, trajtimet e tillë kushtojnë shumë, gjendja e tij ekonomike është katastrofale nëse, ka mundësi DSHMS-ja, me i ndihmues me mjete materiale. Tjetra është fryrja e fakturave të energjisë elektrike në fshatin Breznicë, pasi që s’kemi pasë rrymë qe 2 muaj po flas personalisht për shtëpinë time faktura ka ardhë 50 €. Për këtë ngjarje ka qenë Televizioni, ka pasë reportazh dhe mendoj se dikush duhet me ndërmarrë diçka sepse është fryrje shumë e madhe e fakturave. Unë e kam një vërejtje te magjistralja Obiliq-Prishtinë, prej ambullantës të KEK-ut deri te ura e autostradës, zhavorri anësor që është shtrue ju mund ta shihni edhe vet, që duket si me qenë baltë e Kozaricës. Poashtu, e njejta është edhe rruga Palaj deri te ura e Sitnicës.

**Samire Berisha** – Unë e kam vetëm një pyetje për Drejtoren e Arsimit, pse disa mësimdhënës e kanë kontratën 1 vjeçare, ndërsa të tjerët në kohë të pacaktuar. Shumica janë të punësuar në kohë të pacaktuar, por vetëm disa janë me kontratë 1 vjeçare dhe vetëm Komuna e Obiliqit e ka këtë sistem, ndërsa Komuna tjera e kanë të përgjithshme ose të përhershme.

**Qëndresa Dubova** – Unë e kam një kërkesë për DMM-në, znj. Fitore Hashani, të cilën së pari e përgëzoj për punën e mirë që e bën sa i përket çështjes së ambientit, duke marrë parasysh se udhëheqë një Drejtori të ndjeshme. Problemi i hudhjes së mbeturinave në vendet jo të duhura është i shprehur në tërë Kosovën, e jo vetëm në Komunën tonë, prandaj kërkoj nga drejtoresha që në buxhetin për vitin 2019 të jetë përfshirja e blerjes së disa shportave të mbeturinave, në mënyrë që të bëhet shmangia dhe mbrojtja nga mbeturinat. Poashtu, është mirë të mbjellen edhe disa pemë në zonat ku është e lejueshme.

**Shaip Paloja** – Mendoj se gjendja me energjinë elektrike në Komunën tonë, sidomos në ditët e fundit ka qenë katastrofale. Është e papërbollueshme 8 orë, 10 orë mos me pasë energji elektrike kur dihet se për Obiliqin, është votue dhe është një ligj për Obiliqin. Neve, na takon të jemi të favorizuar në këtë rast, ose nëse flasim për kategori duhet të jemi kategoria A + që edhe në mungesë të energjisë në Kosovë, patjetër ne nuk bën të mbetemi pa energji elektrike. Komuna jonë duhet zyrtarisht ti drejtohet KEDS-it, dhe ata ti kryejnë obligimet ligjore që i kanë ndaj Komunës tonë, ose mund të ndodhë edhe një pakënaqësi qytetare, që mendoj se nuk është e mirë për askend. Ajo që është më e keqja nëpër rrjetet sociale shkruajnë individë të caktuar se për këtë defekt energetik faji është te kualicioni në Komunën PD, LDK dhe AAK. Unë ju them me përgjegjësi të plotë se LDK-ja, nuk ka kurrfarë kualicioni zyrtarisht me AAK-në dhe LDK-në, në Komunën e Obiliqit e përfqaqësojnë 5 anëtarë të Kuvendit, që janë në legjislativ. Asnjë strukturë zyrtare e LDK-së, absolutisht nuk është në Ekzekutivin e kësaj Komune. Ne kontributin tonë në Kuvend, e kemi dhënë dhe prapë do ta japim gjithmonë në interes të qytetarit, por dua ta them zyrtarisht dhe publikisht me përgjegjësi të plotë, se ne nuk kemi kualicion dhe nuk jemi pjesë e pushtetit komunal në Obiliq.

**Hysni Mjeku** – Unë e kam një kërkesë që rekomandimet dhe procesverbalet e KPF-së, t’ju dërgohen të gjithë anëtarëve të Kuvendit, në mënyrë që ne të jemi sa më racionali në kohë dhe mos t’ju marrim të tjerëve kohë sepse po mbetet si konstatim se nuk kemi bërë asgjë aty, ndërsa faktikisht ne i humbim 2,3 orë aty.

**Burim Gërguri** – Sqaron se rekomandimet juve po ju vijnë, ndërsa procesverbali s’ka mundësi të kryhet për 2 ditë.

**Hysni Mjeku** - Unë e di që është ngarkesë, por është mirë që seancat e KPF-së, me i caktue pak më heret, ndërsa mbledhjen e Kuvendit si zakonisht.

**Aziz Bici** – Unë ju kam drejtue Kryetarit përmes kryesuesit dhe dua ta lexoj tash kërkesën sepse ju nuk po i shpérndani dhe për mua, është shumë e rëndësishme të gjitha kërkesat të shpérndahen.

**Burim Gërguri** – Sqaron se zyra për informim do ta japë përgjegjen dhe Drejtoria e administratës është në dijeni. Lënda ka ardhë te Kryetari dhe unë e kam një kopje. Ju keni kërkuar qasje në dokumentet zyrtare për çështjen e emërimit të sheshit dhe mbetet që me ta dhënë një përgjegje.

**Aziz Bici** – Lexoi kërkesën lidhur me propozimin dhe miratimin e sheshit të qytetit me emrin e të ndjerit “Adem Preniqi” për të kërkuar të paktën informata publike që i lejon ligji nr.03-L-215, përkatësisht neni 4 i këtij ligji për qasje në dokumentet publike. Informatat kërkohen me shkrim për pyetjet e poshtë shenuara:

- Kur dhe ku është shpallë debati publik për emrin e sheshit
- Këto debate a janë mbajtur në degë të ndonjë partie politike apo në objekte të dedikuara për debate publike
- A mund të na ofroni procesverbalet e tubimeve të mbajtura,
- Pse ne si asambleistë dhe qytetarë nuk kemi qenë të informuar për këto debate
- A është krijuar ndonjë Komision për ti hartuar kushtet dhe kriteret e këtij lloj emërimi

**Burim Gërguri** - Unë kërkesën e kam parë, ke kërkuar qasje në dokumentet zyrtare dhe për shkak të transparencës besoj se do të keni qasje.

**Mbledhja përfundoi në ora 13:25'**

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal

  
Burim Gërguri

